



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:066396

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05308180

P.2023:066397

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.M, i shpallur fajtor për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 82/2023 të datës 13.03.2023 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 30.01.2024, në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Sylja - Hyseni, të pandehurit, më datë 02.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 09.02.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri: B.M, nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, i lindur me datë ..., nga babai N... dhe nëna B..., e gjinisë Shkreta, ka të kryer shkollen Fillore, i martuar, baba i 4 Fëmijëve, i gjendjes së mesme, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

### ËSHTË FAJTOR

Më datë 25 dhjetor 2022, rreth orës 01:14, në rrugën magjistrale Kaçanik - Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës ... me ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit ..., nën ndikim të alkoolit ka shkaktuar aksident, ashtu që me të arritur te pompa e derivateve "... nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë dhe nga mbrapa e godet me pjesën e

pare e godet në pjesën e pasme anën e djathë automjetin ... ngjyrë e bardhë, me targa ..., të cilin ka qenë duke e drejtuar i dëmtuari G. K. i cili qenë duke lëvizur në drejtim e njëjtë dhe ka qenë duke kaluar në shiritin e kundërt për të tejkaluar pengesën në rrugë, nga kjo goditje rrokulliset dhe del nga rruga në anën e majtë të drejtimit të lëvizje, me ç' rast ka shkaktuar dëme materiale, pastaj të pandehurit i është bërë alkool testi dhe rezultuar se ka konsumuar alkool me 0.76 promilë.

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 paragrafi 1 të KPRK-së

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

## DËNIM ME KUSHT

I. Dënim me gjobë në shumë 1000€, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër penale tjetër, në afatin prej 1 viti (periudha verifikuese), pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 30.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 82/2023 të datës 13.03.2023 kundër të pandehurit B.M, për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i ka propozuar

gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i cili dënim do ti përgjigjej të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale, dhe me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 30.01.2024.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka deklaruar se është penduar për veprën penale.

Prokurori i shtetit ka dhënë pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka deklaruar se pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë ky pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është bërë konform nenit 242 të KPPK-së. E ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit si dhe ky pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza dhe i propozoj gjykatë që të pranojë këtë pranimi i fajësisë, gjatë matjes dhe shqyrtimit të dënimit gjykata të ketë përsysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese si rrethanë lehtësuese të marrët parasysh pranimiti i fajësisë në këtë shqyrtim fillestar ndërsa si rrethanë rëndues të merret parasysh se u i njëjti ka ngasë veturën në gjendje të dehur dhe ka shkaktuar aksident në komunikacion dhe me këtë veprim i ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar e ka njoftuar gjykatën se i pandehuri e ka bërë riparimin e dëmit të shkaktuar.

#### *Vlerësimi i pranimit të fajësisë*

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë

vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 paragrafi 1 të KPRK-së, si në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### *Rrethanat për matjen e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, pendimin për veprën e kryer, në bazë të evidencës së të dhënave penale nuk ka të dhëna se i njëjti ka rënë ndesh me parë në kundërshtim me ligjin, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërit vepra penale, ndërsa si rrethana rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Gjykata të pandehurit nuk i ka shqiptuar dënim plotësues, ndalim i drejtimit të automjetit, pasi që në bazë të evidencës penale dhe kundërvajtëse të pandehurit të verifikuar në sistemin SMIL, nuk ka rezultuar se i pandehuri është recidivist.

*Kërkesat pasurore juridike*

Duke u bazuar në nenin 462 të KPP-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

P.2023:066397, më datë 09.02.2024

Procesmbajtësi:

Ismail Kuçi

Gjyqtari:

Burim Çaka

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.